



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, 1 shkurt 2017
Nr. ref.:RK1034/17

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KO120/16

Parashtrues

Slavko Simić dhe 10 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 05/L-079 për Investimet Strategjike në Republikën e Kosovës

GJKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërzhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues të kërkesës janë: Slavko Simić, Jelena Bontić, Saša Milosavljević, Milka Vuletić, Jasmina Živković, Slobodan Petrović, Bojan Mitić, Milena Miličević, Srđan Popović, Nenad Rašić dhe Adem Hodža (në tekstin e mëtejme: parashtruesit e kërkesës), që të gjithë deputetë të zgjedhur të Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kuvendi).

2. Parashtruesit e kërkesës kanë autorizuar z. Slavko Simić që t'i përfaqësojë në procedurë para Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).

Ligji i kontestuar

3. Parashtruesit e kërkesës kontestojnë kushtetutshmërinë e Ligjit nr. 05/L-079 për Investimet Strategjike në Republikën e Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji për Investimet Strategjike), të miratuar nga Kuvendi më 11 tetor 2016.

Objekti i çështjes

4. Parashtruesit kërkojnë nga Gjykata që të vlerësojë kushtetutshmërinë e Ligjit të kontestuar për Investimet Strategjike në baza përmbajtjesore dhe procedurale.
5. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Ligji i kontestuar për Investime Strategjike është në kundërshtim me nenin 22 (Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare), nenin 46 (Mbrojtja e Pronës), nenin 49 (E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit) nenin 58 (Përgjegjësitë e Shtetit), nenin 60 (Këshilli Konsultativ për Komunitete), nenin 78 (Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve) dhe 81.1 (Legjislacioni me Interes Vital), nenin 123 (Parimet e Përgjithshme) dhe nenin 124 (Organizimi dhe Funkionimi i Vetëqeverisjes Lokale) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), si dhe Kartën Evropiane të Vetëqeverisjes Lokale.
6. Thelbi i kërkesës së parashtruesve është se Ligji i kontestuar për Investimet Strategjike është me interes vital për komunitetin serb në Kosovë, dhe për këtë arsye, ishte e nevojshme që të ndiqet procedura e paraparë me nenin 81.1 të Kushtetutës. Si një ligj me interes vital, sipas parashtruesve, Ligji për Investime Strategjike duhej të miratohej nga shumica e deputetëve të Kuvendit të pranishëm dhe që votojnë dhe nga shumica e deputetëve të Kuvendit të pranishëm dhe që votojnë që mbajnë vende të rezervuara për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë.
7. Parashtruesit gjithashtu kërkojnë nga Gjykata që të vendosë masë të përkohshme dhe që Ligji për Investime Strategjike të *“PEZULLOHET në pajtim me nenin 27 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese deri sa të nxirret vendimi përfundimtar për kushtetutshmërinë e ligjit të kontestuar. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nxjerrjes së tij.”*

Baza juridike

8. Kërkesa bazohet në nenin 113.5 dhe 116.2 të Kushtetutës, dhe nenet 27, 42 dhe 43 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji).

Procedura në Gjykatë

9. Më 18 tetor 2016, parashtruesit e dorëzuan kërkesën dhe kopjet e letërnjoftimeve të tyre në Gjykatë.
10. Më 19 tetor 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Arta Rama-Hajrizi dhe Gresa Caka-Nimani (gjyqtare).
11. Më 19 tetor 2016, Gjykata i njoftoi parashtruesit për regjistrimin e kërkesës.
12. Më 19 tetor 2016, kërkesa iu dërgua Presidentit të Republikës së Kosovës, Kryeministrit të Republikës së Kosovës, Avokatit të Popullit të Kosovës dhe Kryetarit të Kuvendit me udhëzim që t'u jepet mundësia të gjithë deputetëve të Kuvendit që të paraqesin komente. Kërkesa gjithashtu i është dërguar edhe Sekretariatit të Kuvendit, të cilit i është kërkuar të dorëzojë një kopje të versionit përfundimtar të miratuar të Ligjit për Investimet Strategjike, një kopje të procesverbalit të seancës plenare të Kuvendit, si dhe duke përfshirë dokumentet tjera të vlefshme në lidhje me këtë rast. Të gjitha institucioneve të lartpërmendura u ishte kërkuar që të paraqesin komentet e tyre lidhur me kërkesën, nëse kanë, deri më 2 nëntor 2016.
13. Më 21 tetor 2016, Zyra e Kryetarit të Kuvendit dorëzoi dokumente shtesë lidhur me kërkesën, duke përfshirë: Vendimin e Qeverisë së 1 dhjetorit 2015, me të cilin u miratua Projektligji për Investime Strategjike; Certifikatën e përputhshmërisë procedurale të Projektligjit për Investime Strategjike të 1 dhjetorit 2015; Letrën e 4 dhjetorit 2015, të Kryetarit të Kuvendit me të cilën ua dërgoi Projektligjin për Investimet Strategjike komisioneve parlamentare përkatëse për shqyrtim; Raportin me rekomandimet e Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri i 22 dhjetorit 2015; Vendimin për mbajtjen e seancës plenare të Kuvendit dërguar deputetëve të Kuvendit me rendin e ditës së rekomanduar për 16 shkurt 2016; Procesverbalin e seancës plenare të mbajtur nga 19 shkurti deri më 24 shkurt 2016; Vendimin e Kuvendit për miratimin në parim të Projektligjit për Investime Strategjike, të 19 shkurtit 2016; Raportin me amendamente të Komisionit për Zhvillim Ekonomik në Projektligjin për Investime Strategjike të 21 prillit 2016; Raportin me rekomandime nga Ministria e Financave të 10 majit 2016; Raportin me rekomandime të Komisionit për Integrimin Evropian të 10 majit 2016; Raportin me rekomandimet e Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri i 31 majit 2016; Njoftimin e Kryetarit të Kuvendit dërguar deputetëve për mbajtjen e seancës plenare dhe për rendi i ditës i rekomanduar së 3 qershorit 2016; Procesverbalin e seancës plenare të mbajtur më 9 qershor 2016; Kërkesën Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri për rishikimin e ligjit pas rekomandimeve të 9 qershorit 2016; Raportin e Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri i 21 qershorit 2016; Njoftimin e 4 korrikut 2016 të Kryetarit të Kuvendit dërguar deputetëve për mbajtjen e seancës plenare duke përfshirë rendin e ditës; Procesverbalin e seancës plenare të mbajtur nga 7 korriku deri më 11 korrik 2016; Kërkesën e 13

shtatorit 2016 të Komisionit FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri Kryetarit të Kuvendit për përfshirjen e Projektligjit për Investime Strategjike në rend të ditës; Njoftimin e 10 tetorit 2016 të Kryetarit të Kuvendit dërguar deputetëve për mbajtjen e seancës plenare me rendin e ditës së rekomanduar; Procesverbalin e seancës plenare të mbajtur më 11 tetor 2016; Vendimin e 11 tetorit 2016 të Kryetarit të Kuvendit për miratimin e Ligjit për Investimet Strategjike; Kopjet e Ligjit për Investimet Strategjike, në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës.

14. Në letrën e 21 tetorit 2016, Kryetari i Kuvendit tregoi që në seancën plenare të Kuvendit të mbajtur më 19 shkurt 2016, Kuvendi miratoi Ligjin për Investimet Strategjike në leximin e parë, dhe caktoi komisionet përkatëse për shqyrtimin e Projektligjit dhe t'i dorëzojnë komentet e tyre brenda afatit të paraparë në Rregulloren e punës së Kuvendit.
15. Komisionet e caktuara ishin: (1) Komisioni FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri; dhe komisionet e përhershme: (2) Komisioni për Buxhet dhe Financa; (3) Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim; (4) Komisioni për Mandate, Imunitete, Rregulloren e punës dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit dhe (5) Komisioni për Integritime Evropiane.
16. Më 25 tetor 2016, Komisioni FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri dorëzoi komentet e veta lidhur me kërkesën.
17. Më 2 nëntor 2016, përfaqësuesi i autorizuar i parashtruesve dorëzoi argumente plotësuese në mbështetje të kërkesës.
18. Më 7 dhjetor 2016, Gjykata i dërgoi Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit dhe përfaqësuesit të autorizuar të parashtruesve një kërkesë për sqarim shtesë të procedurës së Kuvendit në lidhje me miratimin e ligjit.
19. Më 13 dhjetor 2016, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit dorëzoi përgjigje.
20. Më 15 dhjetor 2016, përfaqësuesi i autorizuar i parashtruesve të kërkesës dorëzoi përgjigje.
21. Më 20 janar 2017, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës ta deklarojë kërkesën të papranueshme dhe ta refuzojë kërkesën për masë të përkohshme si të paaplikueshme.

Përmbledhja e fakteve

22. Më 1 dhjetor 2015, me Vendimin Nr. 01/61, Qeveria e Kosovës miratoi Projektligjin për Investime Strategjike, dhe e përcolli atë në Kuvend për procedurë të mëtutjeshme.
23. Më 4 dhjetor 2015, Kryetari i Kuvendit u dërgoi letër 05/L-079 me Projektligjin për Investime Strategjike deputetëve të Kuvendit dhe Komisionit FunkSIONAL

për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, për të shqyrtuar projektligjin dhe t'ia dorëzojë Kuvendit një raport me rekomandime.

24. Më 21 dhjetor 2015, Komisioni Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, u dërgoi deputetëve të Kuvendit, rekomandimin për miratimin në parim të Ligjit Nr. 05/L-079 për Investimet Strategjike. Në rekomandimin e Komisionit thuhet:

“Komisioni, pas shqyrtimit në parim të Ligjit Nr. 05/L-079 për Investimet Strategjike në Republikën e Kosovës vlerësoi se ai i plotëson kërkesat e nenit 56 të Rregullores së punës të Kuvendit dhe në të njëjtën kohë ka miratuar këtë të fundit në parim.”

25. Më 16 shkurt 2016, Kryetari i Kuvendit u dërgoi një njoftim deputetëve të Kuvendit për caktimin e seancës plenare të Kuvendit për 19 shkurt 2016, me fillim në orën 10:00. Njoftimi përmban rendin e ditës të rekomanduar; ku pika 13 e rendit të ditës të seancës plenare renditej *“leximi i parë i Ligjit për Investimet Strategjike në Republikën e Kosovës.”*

26. Më 19 shkurt 2016, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për Investimet Strategjike. Sipas komenteve të dorëzuar më 21 tetor 2016 nga Kryetari i Kuvendit,

“Kuvendi i Republikës së Kosovës, në seancën plenare të mbajtur më 19 shkurt 2016, ka miratuar në shqyrtim të parë Projektligjin nr. 05/L-079 për Investimet Strategjike në Republikën e Kosovës dhe ka ngarkuar Komisionin funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukture, Tregti dhe Industri dhe komisionet e perhershme: Komisionin për Buxhet dhe Financa; Komisionin për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim; Komisionin për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikeqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit dhe Komisionin për Integrime Evropiane, që në afatin e parapare me Rregulloren e Kuvendit, ta shqyrtojnë Projektligjin për Investimet Strategjike në Republikën e Kosovës dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime për shqyrtim të dytë në seancë plenare.”

27. Më 21 prill 2016, Komisioni Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, ua dërgoi rekomandimin e tij, me amendamentet e Ligjit për Investimet Strategjike komisioneve të përhershme të Kuvendit. Sipas komenteve të dorëzuar më 21 tetor 2016 nga Kryetari i Kuvendit,

“Komisioni funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukture, Tregti dhe Industri, në disa mbledhje të mbajtura ka shqyrtuar dhe amendamentuar Projektligjin për Investimet Strategjike në Republikën e Kosovës, kurse në mbledhjen e mbajtur më 21 prill 2016, ka proceduar Raportin me amendamente për shqyrtim në komisionet e perhershme: Komisionin për Buxhet dhe Financa; Komisionin për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim; Komisionin për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikeqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit dhe Komisionin për Integrime Evropiane.”

28. Më 10 maj 2016, Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, ia dërgoi rekomandimet e tij lidhur me projektligjin me amendamente Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri.
29. Më 10 maj 2016, Komisioni për Integritet Evropian i dërgoi Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri Raportin nr. 49/05 ku theksohet që Projektligji për Investimet Strategjike nuk është në kundërshtim me legjislacionin e Bashkimit Evropian.
30. Më 21 maj 2016, Komisioni për Buxhet dhe Financa i dërgoi Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri Raportin nr. 05/2029/L-079 dhe konstatoi që projektligji është brenda kostos buxhetore të përballueshme për buxhetin e Kosovës.
31. Sipas komenteve të dorëzuara më 21 tetor 2016 nga Kryetari i Kuvendit,

“Komisioni për Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim, nuk e ka shqyrtuar Projektligjin për Investimet Strategjike në Republikën e Kosovës së bashku me amendamentet e Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukture, Tregti dhe Industri, në afatin e parapare me nenin 57, paragrafi 8 të Rregullores së Kuvendit.”
32. Më 3 qershor 2016, Kryetari i Kuvendit dërgoi një njoftim deputetëve të Kuvendit për caktimin e seancës plenare të Kuvendit më 9 qershor 2016, me fillim në orën 10:00. Njoftimi përmbante rendin e ditës të rekomanduar, ku si pika 9 e rendit të ditës të seancës plenare ishte renditur *“Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Investime Strategjike në Republikën e Kosovës.”*
33. Më 9 qershor 2016, Kuvendi nuk e miratoi Projektligjin për Investimet Strategjike, për shkak të dy (2) amendamenteve në nenin 32 të Ligjit, të propozuar nga Komisioni për Buxhet dhe Financa. Projektligji i është kthyer Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, për një shqyrtim tjetër.
34. Më 13 shtator 2016, Komisioni Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, i dërgoi Kryesisë së Kuvendit, një propozim që Projektligji Nr. 05/L-79 për Investimet Strategjike të përfshihet në rendin e ditës së sesionit vjeshtor të Kuvendit me një korrigjim teknik të nenit 32 të Ligjit.
35. Më 10 tetor 2016, Kryetari i Kuvendit ua dërgoi njoftimin SP-077 LV me rendin e ditës së propozuar të gjithë deputetëve të Kuvendit që seanca e ardhshme plenare e Kuvendit do të mbahej më 11 tetor 2016 në orën 10:00.
36. Në rendin e ditës së seancës plenare të caktuar për 11 tetor 2016, si pika e 9 (nëntë) është renditur, *“leximi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-79 për Investimet Strategjike në Republikën e Kosovës.”*

37. Më 11 tetor 2016, me Vendimin nr. 05-V-362, pas leximit të dytë të projektligjit në seancë plenare, Kuvendi miratoi Ligjin për Investime Strategjike në Republika e Kosovës Nr. 05/L-79. Gjatë seancës plenare, kur u miratua Ligji për Investime Strategjike ishin të pranishëm tetëdhjetë e dy (82) deputetë nga të cilët pesëdhjetë e shtatë (57) deputetë votuan për projektligjin, katërbëdhjetë (14) deputetë votuan kundër, ndërsa njëmbëdhjetë (11) deputetë abstenuan.
38. Qëllimi i Ligjit për Investime Strategjike theksohet në nenin 1 të Ligjit i cili përcakton:
1. *Ky ligj ka për qëllim nxitjen, tërheqjen dhe krijimin e kushteve për realizimin e investimeve strategjike në Republikën e Kosovës, si dhe të përcaktojë procedurat administrative dhe kriteret për vlerësimin, zgjedhjen, implementimin dhe mbikëqyrjen e projekteve strategjike si dhe përcaktimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim të pronës së Republikës së Kosovës për qëllim të zbatimit të projekteve për investime strategjike.*
 2. *Institucionet dhe autoritetet e Republikës së Kosovës për zbatimin e këtij ligji do të respektojnë parimet e lëvizjes së lirë të mallrave, shërbimeve dhe kapitalit, parimet e konkurrencës së lirë dhe trajtimit të barabartë, parimit të mosdiskriminimit, të transparencës, proporcionalitetit dhe respektit reciprok.*
 3. *Ky ligj mbështet parimet dhe kushtet e përcaktuara në legjislacionin e zbatueshëm për ndihmë shtetërore, dhe ato që dalin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit.*
39. Fushëveprimi i zbatimit të Ligjit për Investime Strategjike theksohet në nenin 2 të Ligjit i cili përcakton që:
- “1. Statusi i investimit strategjik ose projektit investues strategjik mund të fitohet sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara me Ligj për projektet nga sektorët prioritar të zhvillimit ekonomik e social të cilët i kontribuojnë rritjes ekonomike, punësimit dhe zbatimit të teknologjive të reja, rritjes së aftësisë konkurruese të ekonomisë së Kosovës, rritjes së eksportit dhe zvogëlimit të deficitit tregtar dhe që përgjithësisht ndikojnë në rritjen e mirëqenies dhe kushteve të jetesës së qytetarëve të Republikës së Kosovës në sektorët si:*
- 1.1. *energji me infrastrukturë dhe miniera;*
 - 1.2. *transport dhe telekomunikacion;*
 - 1.3. *turizëm;*
 - 1.4. *industri përpunuese;*
 - 1.5. *bujqësi dhe industri ushqimore;*
 - 1.6. *shëndetësi;*
 - 1.7. *parqe industriale dhe teknologjike;*
 - 1.8. *administrimi i ujërave të zeza dhe mbeturinave”*

2. Vëllimi minimal i investimit për të fituar statusin e investimit strategjik është si vijon: për nën-paragrafët: 1.1, 1.2 dhe 1.6 së paku tridhjetë (30) milion euro; për nën-paragrafët 1.3 dhe 1.4: së paku njëzet (20) milion euro, për nën-paragrafët: 1.5, 1.7 dhe 1.8 së paku dhjetë (10) milion euro.

3. Prioritetet në përzgjedhjen e projekteve për të fituar statusin e investimit strategjik do t'u jepet projekteve me vëllim më të madh investimesh dhe të cilat gjenerojnë në shumë vende pune.

4. Sipas këtij Ligji statusin e investimit strategjik mund të marrin edhe projektet që realizohen në kuadër të marrëveshjeve ndërshtetërore, projektet që realizohen në bashkëpunim me BE-në dhe ato me institucionet financiare ndërkombëtare.

5. Investimet e propozuara për t'u konsideruar strategjike në kuptim të këtij ligji, duhet t'i përmbushin edhe kriteret si më poshtë:

5.1. Subjekti investues në momentin e aplikimit për marrjen e statusit investime strategjike duhet të paraqesë dëshmi për aftësinë e tij të mjaftueshme financiare për realizimin e investimeve;

5.2. investimet e propozuara duhet të jenë në pajtueshmëri me standardet mjedisore të përcaktuara me legjislacionin e Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian;

5.3. investimet e propozuara nuk duhet të jenë në kundërshtim me Kushtetutën dhe me obligimet e Republikës së Kosovës të përcaktuara me konventat dhe marrëveshjet ndërkombëtare.

40. Ligji për Investimet Strategjike ka të bëjë me bartjen e të drejtës së shfrytëzimit të pronave të paluajtshme të ndërmarrjeve shtetërore, publike dhe shoqërore në nenet 18, 22 dhe 23. Këto nene parashohin:

“Neni 18. Përdorimi i pasurive të paluajtshme shtetërore për realizimin e investimeve strategjike

1. Disponimi me pasurinë e paluajtshme të Republikës së Kosovës për të realizuar projektet lidhur me investimet strategjike rregullohet me ligjet që kanë të bëjnë me qeverisjen dhe përdorimin e pronës shtetërore e publike, të drejtat pronësore, ligjin mbi obligacionet dhe ligjet që rregullojnë shfrytëzimin dhe disponimin e pronës së Republikës së Kosovës, nëse me këtë ligj nuk është rregulluar ndryshe.

2. Prona e Republikës së Kosovës duke përfshirë pyjet, tokën pyjore, tokën bujqësore, rrugët publike do të jetë në diskonim të Qeverisë së Kosovës nëpajtim me rregullimin hapësinor dhe urbanistik. Kjo pronë mund të përdoret nga Qeveria për të realizuar projektet me negociata direkte, sipas dispozitave të nenit 4 paragrafëve 1 deri 6 të këtij Ligji.

3. Qeveria parasheh procedura e dhënies në shfrytëzim të pronës nga paragrafi 2 i këtij nenin dhe mund të angazhojë një ekspert gjyqësor për të caktuar vlerën e pronës së paluajtshme që jepet në shfrytëzim.

4. Në rast se bartja e pronës e përcaktuar me paragrafin 2 të këtij neni, bëhet me qëllim të realizimit të projekteve strategjike të cilat kanë element të kontratave të parapara me Ligjin përkatës për Partneritet Publiko Privat, rregullat e prokurimit publik duhet të respektohen.

Neni 22. Bartja e të drejtës së shfrytëzimit të pronës së paluajtshme publike dhe shoqërore tek investitori i interesuar

1. Qeveria e Republikës së Kosovës mund të bartë të drejtën e shfrytëzimit të një prone të paluajtshme shoqërore për investime strategjike në bazë të Ligjit për shpronësimin e pronës së paluajtshme, vetëm pasi Kuvendi i Republikës së Kosovës të merr vendim me shumicë të thjeshtë votash.

2. Qeveria e Republikës së Kosovës mund të bartë të drejtën e shfrytëzimit të një prone të paluajtshme publike për investime strategjike vetëm pas vendimit me shumicë të thjeshtë të votave të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

3. Qeveria e Republikës së Kosovës mund të bartë të drejtën e shfrytëzimit të një prone të paluajtshme komunale për investime strategjike vetëm pas vendimit me shumicë të thjeshtë të votave të Kuvendit të Komunës përkatëse.

Neni 23. Bartja e të drejtës së shfrytëzimit të pronës së ndërmarrjes publike tek subjekti investues

1. Qeveria e Republikës së Kosovës mund të bartë të drejtën e shfrytëzimit të pronës së ndërmarrjeve publike, tek subjekti investues për qëllim të zbatimit të ndonjë projekti për investime strategjike.

2. Mënyra e vënies në dispozicion të pasurive të paluajtshme në pronësi të ndërmarrjeve publike për zhvillimin dhe realizimin e projekteve Investuese Strategjike do të rregullohet me akte nënligjore të cilat do të nxjerrën në përputhje me dispozitat e këtij ligj dhe dispozitat e Ligjit përkatës për Ndërmarrjet Publike.”

41. Ligji për Investimet Strategjike i referohet kufizimeve për kohëzgjatjen e bartjes së të drejtës së shfrytëzimit të pronave të paluajtshme në pronësi shtetërore, publike dhe shoqërore në nenin 24. Ky nen parasheh:

“Neni 24. Kohëzgjatja e së drejtës për shfrytëzimin e pronës së Republikës së Kosovës nga ana e subjektit investues

1. Kohëzgjatja e së drejtës për shfrytëzimin e pronës në të cilën janë bërë investimet strategjike përcaktohet me marrëveshjen për investime duke

marrë parasysh kohëzgjatjen maksimale të lejuar me këtë ligj, por kjo e drejtë nuk zgjatë më shumë se deri nëntëdhjetë e nëntë (99) vite.

2. Autoriteti publik përgjegjës, ka për detyrë të japë pëlqimin për vazhdimin e së drejtës për shfrytëzimin e pronës dhe për periudhën tjetër me afat kohor të arsyeshëm, nëse në pronën në të cilën janë bërë investimet e kapitalit të huaj apo vendor janë të ndërtuara objekte apo ndërtesa që janë duke u shfrytëzuar në mënyrë aktive për qëllime afariste.

3. Kur revokohet vendimi për dhënien e statusit të investimit strategjik apo kur shkëputet marrëveshja, sipas kriterëve të këtij ligji, Komisioni duhet t'ia ndërpresë subjektit investues të drejtën e shfrytëzimit të pronës së Republikës së Kosovës e cila është dhënë në shfrytëzim për realizimin e investimit strategjik.”

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

42. Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës pretendojnë shkelje të nenit 22 (Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare), neni 46 (Mbrojtja e Pronës), neni 49 (E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit) Neni 58 (Përgjegjësitë e Shtetit), neni 60 (Këshilli Konsultativ për Komunitete), neni 78 (Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve) dhe 81.1 (Legjislacioni me Interes Vital) neni 123 (Parimet e Përgjithshme) dhe neni 124 (Organizimi dhe Funksionimi i Vetëqeverisjes Lokale) të Kushtetutës, si dhe të Kartës Evropiane të Vetëqeverisjes Lokale.
43. Në lidhje me shkeljen e nenit 81.1 të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës pretendojnë që *“Kur është miratuar Ligji për Investime Strategjike, nuk është respektuar procedurë e paraparë me nenin 81, paragrafi 1, të Kushtetutës së Kosovës e cila shprehimisht përcakton se ligjet me interes vital për komunitete duhet të miratohen me shumicën e votave të deputetëve të Kuvendit të pranishëm dhe që votojnë dhe shumicën e votave të deputetëve të Kuvendit të pranishëm dhe që votojnë të cilët mbajnë vende të rezervuara ose të garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk janë shumicë. Ligji për Investimet Strategjike paraqet një ligj i cili ka ndikim të drejtpërdrejtë në zbatimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre të parapara me nenin 81, paragrafi 1, pika 2, të Kushtetutës.”*
44. Sa i përket shkeljes së nenit 78 të Kushtetutës, parashtruesit pretendojnë se *“kur është miratuar Ligji për Investime Strategjike ka pasur shkelje të procedurës së rregullt për miratimin e ligjit, sepse nuk është respektuar procedura e shqyrtimit të domosdoshëm nga ana e Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve të paraparë me nenin 78 të Kushtetutës, përkatësisht ligji nuk është shqyrtuar nga Këshilli Konsultativ për Komunitete nga neni 60 i Kushtetutës, me të çka janë shkelur të drejtat e komunitetit serb prandaj përfshin përgjegjësinë e Kosovës të paraparë me nenin 58 të Kushtetutës”.*
45. Sa i përket shkeljes së nenin 60 të Kushtetutës, parashtruesit pretendojnë se *“Në pajtim me nenin 60 të Kushtetutës, Këshilli Konsultativ për Komunitete siguron një mekanizëm për shkëmbimin e rregullt të mendimeve ndërmjet komuniteteve dhe Qeverisë, për këtë arsye, ai u siguron Komuniteteve mundësinë për të komentuar lidhur me nismat legjislative dhe politike të cilat përgatiten nga Qeveria. Duke pasur parasysh se Këshilli Konsultativ për Komunitete është privuar nga mundësia për të komentuar për Projektligjin për Investime Strategjike kur u miratua Ligji për Investime Strategjike, kjo paraqet shkelje të nenit 60 të Kushtetutës”.*
46. Përkritazi me shkeljen e nenit 58 të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës pretendojnë që *“Me nenin 58, paragrafi 1 të Kushtetutës, parashihet që Kosova të sigurojë kushte të përshtatshme që u mundësojnë komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre që të ruajnë, të mbrojnë dhe të zhvillojnë identitetin e tyre. Me nenin 58, paragrafi 7, është paraparë që Kosova siguron, në baza jodiskriminuese, që të gjitha komunitetet dhe pjesëtarët e tyre të mund të*

ushtrojnë të drejtat e tyre, të specifikuara me Kushtetutë. Të gjithë shembujt e sipërpërmendur tregojnë se përfaqësuesit e komunitetit serb në Kosovë ishin të privuar nga e drejta e tyre në procesin e vendim marrjes në investimet strategjike, si interes i tyre vital, në këtë mënyrë është shkelur neni 58 i Kushtetutës i cili përshkruan përgjegjësitë e Kosovës”.

47. Sa i përket shkeljes së nenit 46 të Kushtetutës, parashtresit e kërkesës pretendojnë se “neni 46, paragrafi 1, i Kushtetutës garanton të drejtën e pronës. E drejta e pronës paraqet një të drejtë themelore të njeriut të mbrojtur me nenin 1, Protokolli 1 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore. Neni 22 i Kushtetutës parasheh zbatim të drejtpërdrejtë në territorin e Kosovës të marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare të cilat përfshijnë edhe Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore dhe protokollet e saj”.
48. “Nenet 18, 22, 23 dhe 24 të Ligjit për Investime Strategjike janë në kundërshtim me parimet e detyrueshme të së drejtës ndërkombëtare në aspektin e mbrojtjes së të drejtave të pronës të garantuara me Kushtetutë, përkatësisht me Konventën e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut. Në fakt, investitorit strategjik i jepet mundësia që të marrë pa ndonjë kompensim pronën e ndërmarrjeve shoqërore që janë nën administrimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit. Kjo është plotësisht në kundërshtim me Ligjin për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, në të cilën thuhet se ligji është bërë me qëllim që të sigurojë që çdo person i cili pretendon se ka të drejtën e pronësisë ose të kreditorit apo interes, ndaj një ndërmarrjeje ose prone e cila është objekt i privatizimit ose është nën administrimin e Agjencisë, që në bazë të procedurave përkatëse të dëgjohen në lidhje me pretendimet e tyre dhe nëse ata i dëshmojnë pretendimet e tyre, që tu’ mundësohet atyre kompensim adekuat të holla për dëmin e shkaktuar me shkeljen e të drejtave apo të interesave”.
49. Sa i përket shkeljes së nenit 49 të Kushtetutës, parashtresit e kërkesës pretendojnë se “neni 22 i Ligjit për Investimet Strategjike parasheh që Qeveria e Republikës së Kosovës mund të aprovojë të drejtën e shfrytëzimit të ndërmarrjes në pronësi shoqërore ose ndonjë prej pasurive së saj, nën autoritetin administrativ të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, vetëm pasi Kuvendi i Kosovës merr vendim me shumicë të thjeshtë të votave për heqjen e ndonjë ndërmarrjeje në pronësi shoqërore ose pasurinë e saj nga autoriteti administrativ i Agjencisë Kosovare të Privatizimit me qëllim të zbatimit të një Projekti të Investimeve Strategjike për periudhën prej 40 vjetësh në pajtim me nenin 24 të Ligjit për Investimet Strategjike.

Me nenet e lartpërmendura çështja e personalitetit juridik të ndërmarrjes shoqërore prona e së cilës është transferuar tek investitori ka mbetur tërësisht e pazgjithur, përkatësisht çështja e fatit të të punësuarve në ato ndërmarrje në aspekt të vazhdimit ose ndërprerjes së marrëdhënies së punës dhe pretendimet ndaj ndërmarrjes shoqërore e cila është transferuar te një investitor. Me dispozitat e Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit është përcaktuar që të punësuarit në një ndërmarrje shoqërore, prona e së cilës

është shitur përmes procesit të privatizimit apo likuidimit, kanë të drejtë në një kompensim prej 20% të çmimit të shitjes të pronës së ndërmarrjeve shoqërore. Duke pasur parasysh se me Ligjin për Investimet Strategjike, nuk do të ketë shitje të pasurisë së një ndërmarrjeve shoqërore; në vend të kësaj ajo është transferuar falas për shfrytëzim tek investitori strategjik, me të cilën pretendimet e të punësuarve mbeten të parregulluara njëjtë si statusi i tyre i punësimit”.

50. Parashtruesit e kërkesës gjithashtu pretendojnë se bartjet e propozuara të së drejtës për shfrytëzimin e pronave të paluajtshme të ndërmarrjeve në pronësi shtetërore, publike dhe shoqërore që gjenden në territorin e komunave shkelin dispozitat e Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës (Plani i Ahtisaarit) për kompetencat komunale, siç elaborohet në Kapitullin X [Qeverisjes Lokale dhe Organizimi Territorial] i Kushtetutës.
51. Parashtruesit theksojnë se *“Plani i Ahtisaarit në nenin 3 të Shtojcës III, ofron një sërë të kompetencave të komunave. Përveç kësaj, neni 4 i Shtojcës III përcakton një listë të kompetencave të zgjeruara vetanake të komunave. Këto lista janë përfshirë në Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, (në tekstin e mëtejme: Ligji për Vetëqeverisjen Lokale).*

Në Kapitullin 10. Qeverisja Lokale [të Kushtetutës], në nenin 123, para. 3, thuhet:

3. Veprimtaria e organeve të vetëqeverisjes lokale bazohet në këtë Kushtetutë dhe në ligjet e Republikës së Kosovës dhe respekton Kartën Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale. Republika e Kosovës merr parasysh dhe zbaton Kartën Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale në masën e kërkuar nga vendi nënshkrues.

Me nenin 17 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale janë përcaktuar [kompetencat vetanake dhe të zgjeruara të komunave]”.

52. Në fund, parashtruesit kërkojnë nga Gjykata që të vendosë masë të përkohshme në pajtim me nenin 27 të Ligjit, dhe që të pezullojë shpalljen e Ligjit për Investimet Strategjike, sepse *“... zbatimi i këtij ligji në këtë formë mund të shkaktojë dëme të pariparueshme për komunitetin serb në Kosovë”.*

Pranueshmëria e kërkesës

53. Në pajtim me nenin 113.5 të Kushtetutës, qëllimi i Gjykatës është që të shqyrtojë nëse procedurat e ndjekura për miratimin e ligjit të kontestuar në Kuvend dhe nëse përmbajtja e ligjit të kontestuar janë në shkelje të Kushtetutës, siç pretendohet nga parashtruesit e kërkesës.
54. Në këtë drejtim, Gjykata vëren që, kur një ligj apo një akt është në shqyrtim sipas nenit 113.5 të Kushtetutës, procedura e shqyrtimit do të jetë e natyrës pezulluese, ashtu që ligji do të ndalohet për t'u shpallur deri sa Gjykata të ketë marrë vendimin final për rastin.

55. Në fakt, në pajtim me nenin 43 (2) të Ligjit, në rast se një ligj i miratuar nga Kuvendi kontestohet sipas nenit 113.5 të Kushtetutës, *“ligji [...] i tillë mund t’i dërgohet Presidentit të Republikës së Kosovës për shpallje në pajtim me modalitetet e përcaktuara në vendimin final të Gjykatës Kushtetuese për rastin e kontestuar”*, që do të thotë se Ligji i miratuar nuk duhet t’i kthehet Kuvendit por duhet t’i dërgohet Presidentit të Republikës së Kosovës për shpallje, pa nenet të cilat Gjykata i ka shpallur në Aktgjykimin e saj si të papajtueshme me Kushtetutën. (Shih Aktvendimin për papranueshmëri në rastin nr. KO118/13, *Albana Fetoshi dhe 12 deputetë të tjerë të Kuvendit*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit Nr. 04/L-201 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-16s për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013, paragrafët 36 dhe 37).
56. Në mënyrë që ta gjykojë kërkesën e parashtruesve, Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
57. Fillimisht, Gjykata i referohet nenit 113.1 të Kushtetutës, i cili përcakton se *“Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar”*.
58. Për më tepër, Gjykata vëren se kërkesa ishte parashtruar në pajtim me nenin 113, paragrafi 5, të Kushtetutës. Kjo dispozitë kushtetuese përcakton:

“Dhjetë (10) a më shumë deputetë të Kuvendit të Kosovës, brenda një afati prej tetë (8) ditësh nga dita e miratimit, kanë të drejtë të kontestojnë kushtetutshmërinë e çfarëdo ligji ose vendimi të miratuar nga Kuvendi, si për përmbajtjen, ashtu edhe për procedurën e ndjekur”.

59. Në rastin konkret, Gjykata vëren se kërkesa është dorëzuar nga 11 deputetë të Kuvendit, në pajtim me kriteret e nenit 113.5 të Kushtetutës. Kësisoj, parashtruesit e kanë përmbushur kriterin për t’u njohur si palë e autorizuar.
60. Përveç kësaj, Gjykata merr parasysh nenin 42 të Ligjit që rregullon parashtrimin e kërkesës në bazë të nenit 113.5 të Kushtetutës, i cili parasheh që,

“Neni 42 Saktësimi i kërkesës

1. Në kërkesën e ngritur në pajtim me nenin 113, paragrafi 5 të Kushtetutës, ndër të tjera, paraqiten informatat e mëposhtme::

1.1. emrat dhe nënshkrimet e të gjithë deputetëve të Kuvendit që kontestojnë kushtetutshmërinë e ligjit apo vendimit të nxjerrë nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës;

1.2. dispozitat e Kushtetutës apo të ndonjë akti apo ligji që ka të bëjë me këtë kërkesë; dhe

1.3. paraqitjen e provave mbi të cila mbështetet kontesti”.

61. Gjykata konsideron se kriteret e nenit 42, paragrafi 1, nën pikat 1 dhe 2, të Ligjit janë përmbushur sa i përket emrave dhe nënshkrimeve të deputetëve, specifikimit të ligjit të kontestuar dhe dispozitave relevante të Kushtetutës që kanë të bëjnë me procedurën e ndjekur gjatë votimit dhe miratimit të ligjit në Kuvend.
62. Sa i përket afatit, Gjykata vëren se Ligji për Investimet Strategjike është miratuar më 11 tetor 2016, ndërsa kërkesa është dorëzuar në Gjykatë më 18 tetor 2016. Rrjedhimisht, kërkesa është dorëzuar brenda afatit prej 8 (tetë) ditësh të përcaktuar me nenin 113.5 të Kushtetutës.
63. Megjithatë, Gjykata duhet të ketë parasysh kriterin që parashihet me nenin 42, paragrafi 1, pikën 3, të Ligjit, përkatësisht deri në çfarë mase parashtruesit kanë paraqitur dëshmi në mbështetje të pretendimeve të tyre.
64. Në këtë kontekst, Gjykata rikujton rregullat 36 (1) (d) dhe 36 (2) të Rregullores së punës, që përcaktojnë se,

“(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

[...]

(d) kërkesa nuk arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.

(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

(a) kërkesa nuk arsyetohet prima facie, ose

(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese, ose

(c) Gjykata gjen që parashtruesi nuk është subjekt i ndonjë shkeljeje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë; ose

(d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

Përkitazi me procedurën e ndjekur

Shkelja e pretenduar e nenit 81.1 të Kushtetutës

65. Pretendimi kryesor i parashtruesve të kërkesës është që procedura e miratimit të Ligjit për Investimet Strategjike është dashur të ndjekë procedurën e specifikuar në nenin 81 të Kushtetutës lidhur me Legjislacionin me Interes Vital. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Ligji për Investime Strategjike hyn në fushëveprimin e nenit 81, paragrafi 1, pika 2, të Kushtetutës.
66. Neni 81, paragrafi 1, pika 2, i Kushtetutës përcakton që,

“Për miratimin, ndryshimin ose shfuqizimin e ligjeve në vijim, kërkohet vota e shumicës së deputetëve të Kuvendit të cilët janë të pranishëm dhe që votojnë, si dhe të shumicës së deputetëve të Kuvendit që janë të pranishëm

dhe që votojnë, të cilët mbajnë vende të rezervuara ose të garantuara për përfaqësuesit e Komuniteteve që nuk janë shumicë:

[...]

(2) ligjet të cilat zbatojnë të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre, me përjashtim të atyre të përcaktuara me Kushtetutë;”

67. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Ligji për Investimet Strategjike autorizon bartjen e shfrytëzimit të pronës shtetërore dhe të pronës shoqërore, dhe pjesë e rëndësishme të pronës së paluajtshme në komunat me shumicë serbe mbahen nga ndërmarrjet shtetërore dhe shoqërore. Bartja e shfrytëzimit të pronave të tilla në komunat me shumicë serbe mund të prekë një numër të madh të banorëve. Kësisoj, parashtruesit e kërkesës pretendojnë që pjesëtarët e komunitetit serb të Kosovës preken në mënyrë disproporcionale nga ndryshimet e parapara me Ligjin për Investimet Strategjike dhe se, rrjedhimisht, ky Ligj është me interes vital për mbijetesën e komunitetit serb në Kosovë.
68. Gjykata vëren se neni 81, paragrafi 1, përcakton një sërë kriteresh specifike për të përcaktuar cilat ligje konsiderohen se hyjnë në kuptimin e termit ‘ligje me interes vital’. Për më tepër, Gjykata vëren se pika (2) e këtij neni në mënyrë specifike u referohet ligjeve që zbatojnë të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre, të përmendur në Kushtetutë. Këto ligje theksohen në Kapitullin III të Kushtetutës [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre] (Shih Rastin Nr. KO118/16, Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Ligjit Nr. 05/L-120 për Trepçën, Aktvendim për papranueshmëri i 19 tetorit 2016 paragrafi 54).
69. Gjykata më tej vëren se fushëveprimi i Ligjit për Investime Strategjike, neni 2 (1), ka të bëjë me përcaktimin e “*Statusi i investimit strategjik ose projektit investues strategjik mund të fitohet sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara me Ligj për projektet nga sektorët prioritar të zhvillimit ekonomik e social të cilët i kontribuojnë rritjes ekonomike, punësimit dhe zbatimit të teknologjive të reja, rritjes së aftësisë konkurruese të ekonomisë së Kosovës, rritjes së eksportit dhe zvogëlimit të deficitit tregtar dhe që përgjithësisht ndikojnë në rritjen e mirëqenies dhe kushteve të jetesës së qytetarëve të Republikës së Kosovës [...].*”
70. Përveç kësaj, Gjykata rikujton qëllimin e Ligjit për Investime Strategjike siç theksohet në nenin e parë, përkatësisht që, “*Ky ligj ka për qëllim nxitjen, tërheqjen dhe krijimin e kushteve për realizimin e investimeve strategjike në Republikën e Kosovës, si dhe të përcaktojë procedurat administrative dhe kriteret për vlerësimin, zgjedhjen, implementimin dhe mbikëqyrjen e projekteve strategjike si dhe përcaktimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim të pronës së Republikës së Kosovës për qëllim të zbatimit të projekteve për investime strategjike*”.
71. Përveç kësaj, Ligji për Investime Strategjike, në nenin 1 (2), përcakton se “*Institucionet dhe autoritetet e Republikës së Kosovës për zbatimin e këtij ligji*

do të respektojnë parimet e lëvizjes së lirë të mallrave, shërbimeve dhe kapitalit, parimet e konkurrencës së lirë dhe trajtimin të barabartë, parimet të mosdiskriminimit, të transparencës, proporcionalitetit dhe respektit reciprok”.

72. Prandaj, Gjykata vëren se objektivi i Ligjit për Investime Strategjike është përmirësimi i zhvillimit ekonomik, punësimi dhe zbatimi i teknologjive të reja me qëllim të rritjes së aftësive konkurruese të Kosovës për përmirësimin e mirëqenies së përgjithshme dhe kushteve të të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës.
73. Në këtë drejtim, Gjykata konstaton se përfitimet e propozuara të Ligjit për Investime Strategjike nuk janë të kufizuara në një ose një tjetër komunitet, por janë me interes të përgjithshëm publik dhe synojnë mirëqenien e tërë shoqërisë.
74. Gjykata konsideron që, përveç se përmendin që shumë nga bizneset e prekura në sektorët ekonomikë në shënjestër gjenden në komunat me shumicë serbe dhe punësojnë shumë serbë të Kosovës, parashtruesit e kërkesës kanë dështuar të demonstrojnë se si dhe përse konkretisht do të dëmtohej komuniteti serb i Kosovës me Ligjin për Investimet Strategjike.
75. Gjykata përsërit se, sipas nenit 113.5 të Kushtetutës, është përgjegjësi e parashtruesve që të dëshmojnë pretendimet e tyre, duke përfshirë nëse një ligj i kontestuar është dashur të konsiderohej si ligj me interes vital brenda kuptimit të nenit 81.1 të Kushtetutës (*Shih, mutatis mutandis, rasti Nr. KO94/16, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit për Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës, nr. 05/L-010, Aktvendim për papranueshmëri i 25 tetorit 2016, paragrafi 48*).
76. Gjykata konsideron se parashtruesit e kërkesës nuk kanë dëshmuar pretendimet e tyre për shkelje të dispozitave procedurale që përmban neni 81, paragrafi 1, pika 2, i Kushtetutës.
77. Rrjedhimisht, Gjykata konkludon se ky pretendim duhet të refuzohet si qartazi i pabazuar, në pajtim me Kushtetutën.

Shkelja e pretenduar e nenit 78 të Kushtetutës

78. Parashtruesit e kërkesës po ashtu pretendojnë shkelje të dispozitave procedurale që përmban neni 78 i Kushtetutës, pasi që mbledhja e Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim nuk është mbajtur në mes të leximit të parë dhe të dytë të Projektligjit për Investimet Strategjike.
79. Neni 78 i Kushtetutës parasheh:

“Neni 78 [Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve]

- 1. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve është komision i përhershëm i Kuvendit. Ky komision përbëhet nga një e treta (1/3) e anëtarëve që përfaqësojnë grupin e deputetëve të Kuvendit, të cilët mbajnë vende të rezervuara a të garantuara për komunitetin Serb, nga një e treta (1/3) e anëtarëve që përfaqësojnë grupin e deputetëve të Kuvendit, të cilët mbajnë vende të rezervuara a të garantuara për komunitetet e tjera që nuk janë shumicë, dhe një e treta (1/3) e anëtarëve nga komuniteti shumicë, të përfaqësuar në Kuvend.*
 - 2. Me kërkesën e cilitdo anëtar të Kryesisë së Kuvendit, çdo ligj i propozuar do të dorëzohet në Komisionin për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve. Komisioni, me shumicën e votave të anëtarëve të tij, do të vendosë nëse do të bëjë rekomandime në lidhje me ligjin e propozuar brenda dy javësh.*
 - 3. Për të siguruar që të drejtat dhe interesat e komuniteteve janë adresuar si duhet, Komisioni mund t'i bëjë rekomandime komisionit tjetër përkatës ose Kuvendit.*
 - 4. Komisioni, me nismën e vet, mund të propozojë ligje dhe masa të tilla të tjera brenda përgjegjësisë të Kuvendit, të cilat i konsideron se janë të duhura për të adresuar interesat e komuniteteve. Anëtarët e Komisionit mund të japin mendime individuale.*
 - 5. Një çështje mund t'i referohet komisionit për mendim këshillimor nga Kryesia e Kuvendit, një komisioni tjetër, ose një grupi të përbërë nga të paktën dhjetë (10) deputetë të Kuvendit”.*
80. Gjykata vëren nga komentet e marra nga Kryetari i Kuvendit të 21 tetorit 2016, që Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim është eemëruar më 19 shkurt 2016 për shqyrtimin e Projektligjit për Investimet Strategjike dhe të japin komentet e tyre brenda afateve të përcaktuara në Rregulloren e punës së Kuvendit.
 81. Përveç kësaj, Kryetari i Kuvendit tregoi në komentet e tij se më 25 prill 2016 raporti me amendamente të Komisionit FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, është proceduar për shqyrtim në Komisionin për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim.
 82. Kryetari i Kuvendit deklaroi më tej se “Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, nuk e ka shqyrtuar Projektligjin për Investimet Strategjike në Republikën e Kosovës, së bashku me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë , Tregti dhe Industri, brenda afatit të përcaktuar në nenin 57 paragrafi 8 të Rregullores së punës së Kuvendit. (Rregullorja e punës, neni 57, paragrafi 8, “Komisionet e përhershme raportet e veta duhet t'ia paraqesin komisionit funksional, në

afat prej dhjetë (10) ditë pune, nga dita e pranimit të amendamenteve nga komisioni funksional - raportues.”

83. Gjykata vëren së më 2 nëntor 2016, Parashtruesit informoi Gjykatën se nuk është mbajtur ndonjë takim i Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim në mes të leximit të parë dhe leximit të dytë të Ligjit të kontestuar.
84. Më 7 dhjetor, Gjykata kërkoi nga Parashtruesit që të mbështesin më tutje këtë kërkesë. Në të njëjtën ditë, Gjykata ka kërkuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit që të paraqes qartësime të mëtutjeshme sa i përket pretendimeve të Parashtrueseve që Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim nuk është takuar për të diskutuar Ligjin e kontestuar.
85. Më 12 dhjetor 2016, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit i ka konfirmuar Gjykatës se të gjitha informatat sa i përket mbajtjes së takimit të Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim janë përfshirë në komentet që janë shpërndarë nga Kryetari i Kuvendit më 21 tetor 2016.
86. Më 14 dhjetor 2016, Parashtruesit i kanë konfirmuar Gjykatës së nuk është mbajtur ndonjë takim i Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, dhe kanë potencuar së dështimi për tu takuar mund të konfirmohet nga njëri nga Parashtruesit si Kryesues, dhe disa nga Parashtruesit si anëtarë të Komisionit. Për më tepër, Parashtruesit potencuan që dështimi për të mbajtur takimin mund gjithashtu të konfirmohet nga informatat që janë paraqitur në webfaqen e Kuvendit.
87. Për më tepër, Gjykata vëren nga komentet e 25 tetorit 2016 të dorëzuara nga Kryetari i Komisionit Funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, se që nga data e dorëzimit të Projektligjit për Investimet Strategjike të Komisioni Funksional më 21 dhjetor 2015, një prej parashtruesve ka marrë pjesë në të gjitha seancat e këtij Komisioni.
88. Përveç kësaj, Gjykata vëren nga këto komente që njëri prej parashtruesve të kërkesës kishte propozuar amendamentet e Projektligjit për Investimet Strategjike, dhe se të gjitha këto amendamente të propozuara janë votuar, dhe ose janë miratuar ose refuzuar nga Komisioni në përbërje të plotë.
89. Gjykata vëren se Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka pasur kohë të njëjtë në dispozicion për të shqyrtuar Projektligjin për Investimet Strategjike dhe për të përgatitur opinionin e tij për projektligjin si dhe të gjitha komisionet e përhershme.
90. Për më tepër, Gjykata vëren se as Parashtruesit e as Kuvendi nuk kanë potencuar arsyet pse Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim nuk është takuar për të vlerësuar Ligjin e kontestuar.

91. Në këto rrethana, Gjykata konstaton se parashtruesit e kërkesës nuk kanë dëshmuar pretendimet e tyre për shkelje të dispozitave procedurale që përmban neni 78 i Kushtetutës.
92. Prandaj, Gjykata konkludon se ky pretendim duhet të refuzohet si qartazi i pabazuar në pajtim me Kushtetutën.

Shkelja e pretenduar e rregullave 56 dhe 57 të Rregullores së punës së Kuvendit

93. Në lidhje me pretendimet e parashtruesve të kërkesës përkitazi me zbatimin e rregullave 56 dhe 57 të Rregullores së punës së Kuvendit në lidhje me shqyrtimin e Projektligjit për Investime Strategjike nga komisione të ndryshme, Gjykata vëren se fushëveprimi i juridiksionit të Gjykatës sipas nenit 113.5 të Kushtetutës është që të shqyrtojë pajtueshmërinë me rregullat procedurale të përfshira në Kushtetutë, të procedurës së ndjekur në Kuvend, që nuk përfshin shqyrtimin e zbatimit të Rregullores së punës së vetë Kuvendit.
94. Në lidhje me këtë, Gjykata konsideron se parashtruesit nuk kanë dëshmuar se si ky pretendim, që ka të bëjë me Rregulloren e punës së Kuvendit, paraqet shkelje kushtetuese, të cilat Gjykata do të kishte kompetencë që t'i shqyrtonte (Shih, *mutatis mutandis*, rasti Nr. KO94/16, *Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës*, nr. 05/L-010, *Aktvendim për papranueshmëri i 25 tetorit 2016, paragrafi 53*).

Shkelja e pretenduar e nenit 60 të Kushtetutës

95. Sa i përket pretendimit procedural të parashtruesve të kërkesës në lidhje me nenin 60 të Kushtetutës, që Projektligji për Investime Strategjike është dashur të dorëzohet në Këshillin Konsultativ për Komunitete për shqyrtim, Gjykata rikujton se në bazë të nenit 60, paragrafi 3, i Kushtetutës, mandati i Komuniteteve Konsultative është përcaktuar si në vijim:

“3. Mandati i Këshillit Konsultativ për Komunitete përfshin:

- (1) ofrimin e një mekanizmi për shkëmbimin e rregullt ndërmjet komuniteteve dhe Qeverisë së Kosovës;*
- (2) mundësinë e komuniteteve për të komentuar në një fazë të hershme nismat legjislative dhe politike, të cilat mund të përgatiten nga Qeveria, për të sugjeruar nisma të tilla dhe për të kërkuar që pikëpamjet e tyre të përfshihen në projektet dhe programet përkatëse;*
- (3) çdo përgjegjësi a funksion tjetër, në pajtim me ligjin.”*

96. Gjykata vëren se mandati i Këshillit Konsultativ për Komunitete ka të bëjë, *inter alia*, me “mundësinë për të komentuar në një fazë të hershme nismat legjislative dhe politike, të cilat mund të përgatiten nga Qeveria”.
97. Sa i përket fazës në të cilën mandati i Këshillit Konsultativ për Komunitete vjen në shprehje, ajo i paraprin procedurës legjislative. Kjo ka të bëjë me fazën e “nismave legjislative dhe politike” dhe nuk është pjesë e procedurës për

miratimin e një ligji nga Kuvendi, brenda kuptimit të nenit 113.5 të Kushtetutës.

98. Prandaj, Gjykata konsideron se pretendimi i parashtruesve të kërkesës që Këshilli Konsultativ për Komunitete është dashur të konsultohet nuk hyn në kuadër të nenit 113.5 të Kushtetutës. Një konsultim i tillë nuk është pjesë e procedurës legjislative kushtetuese që çon në miratimin e një ligji nga Kuvendi. Prandaj, Gjykata gjen se ky pretendim duhet të refuzohet si jorelevant.
99. Përkitazi me atë se parashtruesit e kërkesës janë thirrur në përgjegjësitë e Shtetit ndaj komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre sipas nenit 58 të Kushtetutës, në lidhje me miratimin e Ligjit për Investime Strategjike, Gjykata gjen se këto pretendime nuk kanë të bëjnë me miratimin e këtij ligji, as në lidhje me procedurë, dhe as me përmbajtje.

Përkitazi me përmbajtjen

Shkelja e pretenduar e nenit 46 [Mbrojtja e Pronës], në lidhje me nenin 1, Protokollin 1, të KEDNJ-së

100. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se bartja e të drejtës së shfrytëzimit të pronës së ndërmarrjeve shtetërore dhe shoqërore, sipas autorizimit nga nenet 18, 22 dhe 23 të Ligjit për Investime Strategjike, përbën shpronësim të pronës në shkelje të nenit 46, paragrafi 3, i Kushtetutës. Ky nen parasheh që,

“3. Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëjë ekspropriimin e pronës nëse ky ekspropriim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave eksproprijohet.”

101. Parashtruesit e kërkesës gjithashtu pretendojnë se kjo bartje e shfrytëzimit të ndërmarrjeve është gjithashtu në kundërshtim me nenin 1, Protokollin 1, [Mbrojtja e Pronës] të KEDNJ-së. Ky nen përcakton që

*“Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.
Megjithatë, dispozitat e mëparshme nuk cenojnë të drejtën e Shteteve për të zbatuar ligje, që ato i çmojnë të nevojshme për të rregulluar përdorimin e pasurive në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave ose të kontributeve ose të gjobave të tjera.”*

102. Parashtruesit pretendojnë që Ligji për Investimet Strategjike, duke autorizuar bartjen e shfrytëzimit të pronës së paluajtshme, në mënyrë efektive shpronëson pronat e ndërmarrjeve në pronësi shtetërore, publike dhe shoqërore, pa kompensim, në shkelje të obligimeve sipas nenit 46 të Kushtetutës.

103. Gjykata rikujton se neni 46 [Mbrojtja e Pronës], paragrafi 3, i Kushtetutës parasheh:

“3. Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëjë ekspropriimin e pronës nëse ky ekspropriim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave ekspropriohet.”

104. Përveç kësaj, Gjykata i referohet nenit 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së ku thuhet:

“Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

Megjithatë, dispozitat e mëparshme nuk cenojnë të drejtën e Shteteve për të zbatuar ligje, që ato i çmojnë të nevojshme për të rregulluar përdorimin e pasurive në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave ose të kontributeve ose të gjobave të tjera.”

105. Edhe pse këto dispozita të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së përmbajnë disa elemente, Gjykata vëren se pretendimet e parashtruesve të kërkesës kanë të bëjnë vetëm me çështjen e kompensimit për shpronësimin e pretenduar të pronës.
106. Gjykata vëren se nenet e kontestuara 18, 22 dhe 23 të Ligjit për Investimet Strategjike tregojnë se çdo bartje e shfrytëzimit të pronave të paluajtshme të, ndërmarrjeve shtetërore, publike ose shoqërore do t'i nënshtrohet, ligjeve për shfrytëzim të pronës shtetërore dhe pronës publike, rregullimit hapësinor dhe urban, Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, dhe Ligjit për Ndërmarrjet Publike, si dhe rregullimit të mëtejshëm në ligjet plotësuese dhe aktet nënligjore.
107. Gjykata vëren se Ligji për Investimet Strategjike i referohet vetëm “bartjes së të drejtës së shfrytëzimit të pronës së paluajtshme”, dhe nuk nënkupton bartjen e pronësisë së plotë. Kjo bartje e së drejtës së shfrytëzimit do t'i nënshtrohet kushteve të tjera të përcaktuara në ligje dhe rregullore të tjera, duke përfshirë në disa raste Ligjin për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme.
108. Përveç kësaj, neni 24 i Ligjit për Investimet Strategjike kufizon kohëzgjatjen e çdo bartjeje të së drejtës së shfrytëzimit dhe thekson se bartja e së drejtës së shfrytëzimit mund të ndërpritet në rastet kur statusi i investimeve strategjike revokohet ose kur ndërpritet marrëveshja me investitorin.
109. Në këto rrethana, Gjykata konsideron se nuk është e mundur që të përcaktohet saktësisht se si do të ndodhin bartjet e propozuara të së drejtës së shfrytëzimit

të pronës së paluajtshme të ndërmarrjeve shtetërore, publike dhe shoqërore. Për më tepër, nuk është e qartë nga Ligji për Investime Strategjike se nuk do të paguhet asnjë kompensim për të drejtën e shfrytëzimit të pronës së paluajtshme të ndërmarrjeve shtetërore, publike dhe shoqërore.

110. Kësisoj, Gjykata konstaton se parashtruesit e kërkesës nuk kanë dëshmuar pretendimet e tyre për shkelje të së drejtës së pronës që mbrohet me nenin 46 të Kushtetutës.
111. Prandaj, Gjykata konkludon që pretendimi i parashtruesve të kërkesës se me Ligjin për Investime Strategjike shkelen dispozitat e nenit 46 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 1, Protokollin 1, të KEDNJ-së, duhet të deklarohet qartazi i pabazuar në pajtim me Kushtetutën.

Shkelja e pretenduar e nenit 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit]

112. Parashtruesit e kërkesës gjithashtu pretendojnë se, për shkak se bartja e shfrytëzimit për një periudhë prej 40 vitesh të pronës të paluajtshme të ndërmarrjeve shoqërore përbën një shpronësim të pronës pa kompensim, siç u diskutua më sipër, kjo në mënyrë efektive ndërhyr në të drejtat e punonjësve të ndërmarrjeve shoqërore për të përfituar nga 20% i vlerës së ndërmarrjes pas privatizimit. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se kjo shkel të drejtën e punës së të gjithë punonjësve të ndërmarrjeve të prekura shoqërore, në kundërshtim me nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës.

113. Neni 49 i Kushtetutës përcakton:

“Neni 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit]

1. E drejta e punës garantohet.
2. Secili person është i lirë të zgjedhë profesionin dhe vendin e punës”.

114. Gjykata rikujton nenet 14 dhe 15 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme (i ndryshuar), të cilët përcaktojnë rregullat themelore në lidhje me kompensimin për shpronësim. Këto nene parashohin që,

KREU IV - BARTJA E PRONËS SË PALUAJTSHME PËRFITUESIT
Neni 14. Bartja e Pronës së Paluajtshme Përfituesit; Bartja e kostos

“1. Nëse Qeveria ka për qëllim të bëjë shpronësimin e të drejtave sipërfaqësore për t'i lejuar bartësit të një licence ose leje të lëshuar nga KPMM ushtrimin e të drejtat e tij në bazë të licencës ose lejes, Qeveria së pari do të kërkojë nga ky bartës që të nënshkruajë një zotim me shkrim për pagimin e kompensimit për personin(at) e shpronësuar. Qeveria e përmbyll Procesin e Shpronësimit vetëm pas pagimit të kompensimit nga bartësi i licencës ose lejes. Qeveria më pas ia bartë të drejtën për shfrytëzimin e pronës në fjalë bartësit të licencës ose lejes. Fushëveprimi dhe kohëzgjatja e kësaj të drejte të shfrytëzimit duhet të jetë e arsyeshme për t'i lejuar bartësit të licencës ose lejes ushtrimin e të drejtave të tij në bazë të licencës ose lejes së tij.”

KREU V – KOMPENSIMI

Neni 15. Rregullat themelore për përcaktimin e shumës së kompensimit

“1. Kompensimi bëhet në bazë të vlerës së tregut të pronës, e cila përcaktohet në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe aktet nënligjore të miratuara në përputhje me paragrafin 6. të këtij neni”.

115. Gjykata vëren se edhe Ligji për Investimet Strategjike edhe Ligji për Shpronësimin parashohin kompensim për shpronësimin e pronës së paluajtshme me qëllim të bartjes së të drejtës së shfrytëzimit.

116. Përveç kësaj, Gjykata kujton nenin 3, paragrafi 4, të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme. Ky nen parasheh që,

Neni 3. Dispozitat e përgjithshme

“[...]

4. Gjithashtu përcaktohet se Qeveria, në përputhje me paragrafin 3 të nenit 4 të këtij ligji mund të shpronësojë të drejtat pronësore ose të drejtat tjera të një Komune ose Autoriteti Publik Komunal në pronën e paluajtshme. Në këto raste, shprehimisht përcaktohet se Komuna

përkatëse ose Autoriteti Publik Komunal ka të drejtat e njëjta si ato të cilat u janë dhënë Personave privat sipas këtij ligji, duke përfshirë të drejtën për kundërshtimin e ligjshmërisë së shpronësimit dhe/ose shkallës së kompensimit [...]”.

117. Gjykata rikujton se ajo ishte thirrur më parë që të shqyrtojë pajtueshmërinë e Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me Kushtetutë, dhe se ajo konstatoi që ky ligj është në përputhje me Kushtetutën (shih Aktgjykimin në rastin Nr. KO04/11 , Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Ligjit për Shpronësim, Nr. 03/L-139).
118. Gjykata vëren se ka konstatuar se mënyra në të cilën Ligji për Investimet Strategjike autorizon bartjen e së drejtës së shfrytëzimit të pronave të paluajtshme nuk do të thotë domosdoshmërisht se nuk do të ketë kompensim të nevojshëm për këtë bartje, dhe as se komunat do të privohen nga të drejtat e tyre. Për më tepër, nuk është e mundur që Gjykata të përcaktojë se bartjet e tilla të së drejtës së shfrytëzimit do të ndërhyjnë në procesin e privatizimit, siç pretendohet nga parashtruesit e kërkesës.
119. Lidhur me deklaratën e parashtruesve të kërkesës se e drejta e shfrytëzimit të pronës së ndërmarrjeve shoqërore mund të bartet për një periudhë prej 40 vitesh, Gjykata vëren se neni 24 i Ligjit për Investimet Strategjike autorizon bartjen e së drejtës së shfrytëzimit të pronës së paluajtshme për një periudhë deri në 99 vjet. Rëndësia e kësaj deklaratë në lidhje me periudhën 40 vjeçare nuk është e qartë për Gjykatën, përkundër dy kërkesave dërguar parashtruesve të kërkesës që t'i sqarojnë pretendimet e tyre.
120. Përveç kësaj, Gjykata konsideron se Ligji për Investimet Strategjike nuk parandalon apo nuk ia mohon askujt të drejtën për punë ose ushtrim të profesionit, në kuptim të nenit 49 të Kushtetutës (shih, *mutatis mutandis*, Aktvendim për papranueshmëri Nr. RK734 / 14 në rastin KIO9 / 14 të 24 nëntorit 2014, paragrafi 29).
121. Gjykata konstaton se parashtruesit e kërkesës nuk kanë dëshmuar pretendimet e tyre për shkeljen e të drejtës për punë, siç mbrohet me nenin 49 të Kushtetutës.
122. Prandaj, Gjykata konkludon që pretendimi i parashtruesve të kërkesës se me Ligjin për Investimet Strategjike shkelen dispozitat e nenit 49 të Kushtetutës duhet të deklarohet qartazi i pabazuar në pajtim me Kushtetutën.

Shkelja e pretenduar e neneve 123 dhe 124

123. Në fund, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se, bartja e autorizuar e së drejtës së shfrytëzimit të pronave të paluajtshme të ndërmarrjeve shoqërore që gjenden në territorin e komunave shkel kompetencat ekskluzive të komunave të garantuara me Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës (Plani i Ahtisaarit), Shtojca III [Decentralizimi], siç zhvillohet në Kapitullin X [Qeverisja Lokale dhe Organizimi Territorial] të Kushtetutës, dhe siç parashihet më tej në nenin 17 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

124. Gjykata rikujton Kapitullin X të Kushtetutës, i cili parasheh:

“Kapitulli X. Qeverisja Lokale dhe Organizimi Territorial

Neni 123 [Parimet e Përgjithshme]

1. E drejta e vetëqeverisjes lokale garantohet dhe rregullohet me ligj.
2. Vetëqeverisja lokale ushtrohet nëpërmjet organeve përfaqësuese të zgjedhura në zgjedhje të përgjithshme, të barabarta, të lira e të drejtpërdrejta dhe me votim të fshehtë.
3. Veprimtaria e organeve të vetëqeverisjes lokale bazohet në këtë Kushtetutë dhe në ligjet e Republikës së Kosovës dhe respekton Kartën Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale. Republika e Kosovës merr parasysh dhe zbaton Kartën Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale në masën e kërkuar nga vendi nënshkrues.
4. Vetëqeverisja lokale bazohet në parimet e qeverisjes së mirë, transparencës, efikasitetit dhe efektivitetit në ofrimin e shërbimeve publike, duke u kushtuar kujdes të veçantë nevojave dhe brengave specifike të komuniteteve që nuk janë shumicë dhe pjesëtarëve të tyre.

Neni 124 [Organizimi dhe Funksonimi i Vetëqeverisjes Lokale]

1. Njësi themelore e vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës është komuna. Komunat gëzojnë shkallë të lartë të vetëqeverisjes lokale dhe inkurajojnë e sigurojnë pjesëmarrje aktive të të gjithë qytetarëve në procesin e vendimmarrjes së organeve komunale.
 2. Themelimi i komunave, kufijtë, kompetencat dhe mënyra e organizimit dhe funksionimit të tyre, rregullohen me ligj.
 3. Komunat kanë kompetenca vetanake, të zgjeruara dhe të deleguara në pajtim me ligjin. Autoriteti shtetëror që delegon kompetencat, përballon shpenzimet për ushtrimin e delegimit.
 4. Komunat kanë të drejtë për bashkëpunimin ndërkomunal dhe për bashkëpunimin ndërkufitar, në pajtim me ligjin.
 5. Komunat kanë të drejtë të vendosin, të caktojnë, të mbledhin dhe të shpenzojnë të hyrat e veta si dhe të marrin fonde nga Qeveria qendrore, në pajtim me ligjin.
 6. Komunat obligohen të respektojnë Kushtetutën, ligjet, dhe të zbatojnë vendimet gjyqësore.
 7. Rishikimi administrativ i akteve të komunave nga autoritetet qendrore në fushën e kompetencave të tyre, kufizohet në sigurimin e përputhjes me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me ligjin.
125. Gjykata vëren se neni 124 (3) i Kushtetutës parasheh që komunat do të kenë “kompetenca vetanake, të zgjeruara dhe të deleguara në pajtim me ligjin”.
126. Megjithatë, Gjykata vëren se Kushtetuta nuk e rregullon çfarë janë këto kompetenca, ose se si ato duhet të zbatohen apo të sigurohen nga komunat. Kjo është çështje e ligjit.

127. Prandaj, Gjykata konstaton se parashtruesit nuk kanë dëshmuar pretendimet e tyre për shkelje të kompetencave të komunave, siç garantohen me nenet 123 dhe 124 të Kushtetutës.
128. Si i tillë, ky pretendim duhet të refuzohet si qartazi i pabazuar në pajtim me Kushtetutën.
129. Për më tepër, Gjykata rikujton se neni 113.4 i Kushtetutës, parasheh: *“Komuna është e autorizuar të kontestojë kushtetutshmërinë e ligjeve ose të akteve të Qeverisë, të cilat cenojnë përgjegjësitë komunale ose zvogëlojnë të hyrat e komunës, në rast se komuna përkatëse është prekur nga ai ligj ose akt”*.

Kërkesa për vendosje të masës së përkohshme

130. Gjykata rikujton se parashtruesit kanë kërkuar që Ligji për Investime Strategjike *“të PEZULLOHET në pajtim me nenin 27 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese deri sa të nxirret vendimi përfundimtar për kushtetutshmërinë e ligjit të kontestuar.”*
131. Lidhur me këtë kërkesë, Gjykata i referohet nenit 43, paragrafi 2, të Ligjit, i cili parasheh që,

“2. Në rast kur ligji apo vendimi i miratuar nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës kontestohet sipas nenit 113, paragrafi 5 i Kushtetutës, ligji apo vendim i tillë mund të dërgohet Presidentit të Republikës së Kosovës për shpallje në pajtim me modalitetet e përcaktuara në vendimin final të Gjykatës Kushtetuese për rastin e kontestuar.”
132. Gjykata konsideron se që qëllimi i synuar me kërkesën e parashtruesve për masë të përkohshme tashmë është arritur me anë të Ligjit.
133. Rrjedhimisht, Gjykata e refuzon kërkesën për masë të përkohshme si të paaplikueshme dhe si të tillë, të papranueshme.

Përfundim

134. Si përfundim, Gjykata konstaton se parashtruesit e kërkesës nuk kanë dëshmuar pretendimin e tyre në baza kushtetuese dhe nuk kanë paraqitur prova që tregojnë se si dhe përse me Ligjin e kontestuar për Investime Strategjike është shkelur Kushtetuta, qoftë për shkak të procedurës, qoftë për shkak të përmbajtjes.
135. Gjykata konkludon se kërkesa e parashtruesve, sa i përket shkeljeve të pretenduara të neneve 22, 46, 49, 58, 60, 78, 81.1, 123 dhe 124 të Kushtetutës, në baza kushtetuese është qartazi e pabazuar, në pajtim me nenin 42 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) (d) dhe 36 (2) të Rregullores së punës.
136. Rrjedhimisht, Gjykata deklaron se Ligji nr. 05/L-079 për Investimet Strategjike në Republikën e Kosovës është në pajtueshmëri me Kushtetutën, që do të thotë se ai është kushtetues.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.5 të Kushtetutës, nenin 27 dhe nenin 42, paragrafi 1.3, të Ligjit dhe rregullat 36 (1) (d) dhe (2) dhe 55 (4) të Rregullores së punës, më 20 janar 2017, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. TË SHPALLË që Ligji nr. 05/L-079 për Investimet Strategjike në Republikën e Kosovës është kushtetues për nga përmbajtja dhe për nga procedura e ndjekur për miratimin e tij nga Kuvendi i Republikës së Kosovës;
- III. TA REFUZOJË kërkesën për masë të përkohshme si të paaplikueshme në bazë të nenit 43.2 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese;
- IV. TË SHPALLË që Ligji nr. 05/L-079 për Investimet Strategjike në Republikën e Kosovës, siç është miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, i dërgohet Presidentit të Republikës së Kosovës për shpallje;
- V. T'UA KUMTOJË këtë vendim parashtruesve të kërkesës, Presidentit të Republikës së Kosovës, Kryetarit të Kuvendit të Kosovës dhe Qeverisë së Kosovës;
- VI. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- VII. TË SHPALLË që ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Ivan Čukalović



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi